

VENDIM
Nr. 197, datë 3.9.2018

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E KODIT TË RRJETIT MBI
RREGULLAT E NDËRVEPRIMIT DHE SHKËMBIMIT TË TË DHËNAVE**

Në mbështetje të neneve 16, 44, 55, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” dhe nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, si dhe parashikimeve të vendimit nr. 2018/02/PHLG-EnC, datë 12.1.2018 të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë të Komunitetit të Energjisë, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 3.9.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike, mbi fillimin e procedurës për miratimin e Kodit i Rrjetit mbi Rregullat e Ndërveprimit dhe Shkëmbimit të të Dhënave,

konstatoi se:

- Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror “Albgaz” sh.a. ka adaptuar/përshtatur Kodin e Rrjetit mbi Rregullat e Ndërveprimit dhe Shkëmbimit të të Dhënave, duke e paraqitur për shqyrtim dhe miratim në ERE, me shkresën nr. 101 prot., datë 8.8.2018;

- Ky Kod do të shqyrtohet dhe miratohet si detyrim i sa më poshtë:

- Shqipëria është anëtare e Komunitetit të Energjisë (ESC) që nga data 1.7.2006;

- Parashikimeve të Rregullores së Bashkimit Evropian (BE) nr. 715/2009, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropës;

- Kërkesave të Rregullores së Komunitetit të Energjisë (KE) 2015/703, të datës 30 prill 2015;

- Vendimit nr. 2018/02/PHLG.EnC, datë 12.1.2018 të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë të Komunitetit të Energjisë me të cilin është miratuar vetëm Kodi i Rrjetit mbi Rregullat e Ndërveprimit dhe Shkëmbimit të të Dhënave, ndërsa dy të tjerët janë akoma në proces shqyrtimi për përshtatje dhe miratim nga vetë Komunitetit të Energjisë, procedura për shqyrtimin e tyre do të fillojë pas miratimit nga ky i fundit.

- Parashikimeve të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”;

Gjithashtu, Operatorit të Kombinuar të Gazit Natyror “Albgaz” sh.a. i lind e drejta për të aplikuar për shqyrtimin dhe miratimin e këtij Kodi, duke qenë se:

- Shoqëria “Albgaz” sh.a. është e licencuar në aktivitetin e transmetimit të dhe shpërndarjes së gazit natyror;

- Është certifikuar Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror “Albgaz” sh.a., në përputhje me nenet 37, 59, 68 dhe 80, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” dhe nenit 9, pika 6, të direktivës 73/2009 të Komunitetit të Energjisë (EC);

- “Albgaz” sh.a. gëzon statusin e vëzhguesit pranë ENTSO-G, Rrjetit Evropian të Operatorëve të Transmetimit të Gazit Natyror.

- Sipas Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, ky Kod duhet të transpozohet pa ndryshuar tekstin apo strukturën e tij.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e “Kodit të Rrjetit mbi Rregullat e Ndërveprimit dhe Shkëmbimit të të Dhënave”.

2. Versioni në gjuhën e origjinës (anglisht) ka përparësi në rast mosdakordësie në interpretim nga palët të versionit shqip.

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë të interesuarit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti